



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry And Rural Development
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë / Agencija za Razvoj Poloprivrede / Agriculture Development Agency

THIRRJE PËR APLIKIM

Prishtinë, 27.12.2024

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, shpall thirrje për aplikim për disa masa dhe nënmasa mbështetëse në kuadër të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2024.

Thirrja për aplikim është hapur për Masën 1 “Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore”, dhe Masën 3, ”Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore”. Investimet e Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit përmes Programit për Zhvillim Rural 2024, për këto dy masa arrijnë vlerën prej është 18,727,000.00 të ndara si në vijim:

Masa 1. Investime në asetet fizike të ekonomive bujqësore

1.1	Pemë drufrutore	1,227,000.00
1.2	Arra, lajthia dhe gështenja	800,000.00
1.3	Pemë manore	800,000.00
1.4	Perime dhe serra, përfshirë serrat për fidane	2,500,000.00
1.5	Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve	1,000,000.00
1.6	Prodhimi i mishit - rritja e viçave	1,200,000.00
1.7	Prodhimi i mishit - rritja e derrave	200,000.00
1.8	Prodhimi i qumështit nga lopët	4,500,000.00
1.9	Prodhimi i qumështit nga delet dhe dhitë	800,000.00
1.10	Pikat grumbulluese të qumështit	200,000.00
1.11	Prodhimi i rrushit	500,000.00
1.12	Prodhimi i vezëve	500,000.00
1.13	Drithëra	1,000,000.00
	Totali i buxhetit	15,227,000.00

Masa 3. Investime në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore

	MASA 3	Buxheti
1	Përpunimi i qumështit	500,000.000
2	Përpunimi i mishit	500,000.000
3	Përpunimi i mishit të shpezëve/investime në thertore	500,000.000
4	Përpunimi i pemëve dhe perimeve dhe pika grumbulluese	500,000.000
5	Përpunimi i verës	700,000.000
6	Pikat grumbulluese/depot	800,000.000
	Totali i buxhetit	3,500,000.000

Përmes këtij Programi përkrahen projektet investuese të fermerëve dhe agrobizneseve në gjithë territorin e Kosovës.

Për Masën 5: Përgatitja zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal – qasja LEADER dhe Masa e menaxhimit të rrezikut në bujqësi - Sigurimet Bujqësore, të interesuarit do të njoftohen përmes thirrjeve të veçanta në kohën e përshtatshme.

MBPZHR përmes PZHR-2024 ka zgjeruar mundësitë e investimeve, duke sjellë risi në masat mbështetëse për sektor, kështu me këtë Program përkrahen për herë të parë investimet në sektorin e drithërave (grurë dhe misër).

Periodha e aplikimit për masat e shpallura do të jetë e hapur nga 27.12.2024 deri me 27.01.2025, në orën 16.00.

Të interesuarit për aplikim mund ta bëjnë këtë përmes ueb –modulit online në webfaqen e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB), www.azhb-ks.net në linkun “Aplikimi online për PZHR”: <https://azhb-aplikimet.rks-gov.net>. Aplikuesit në web – modul do të mund të regjistrojnë projektin, si dhe duhet të ngarkojnë të gjitha dokumentet e nevojshme për aplikim në PDF.

Ndërkaq, gjatë periudhës për aplikim, fermerët dhe agrobizneset për të gjitha informatat lidhur me procedurat e aplikimit, kriteret e pranueshmërisë, kriteret e vlerësimit fushat e investimit, mund t'i marrin në detaje në webfaqen e MBPZHR-së www.mbpzhr-ks.net, si dhe në webfaqen e AZhB-së www.azhb-ks.net.

Po ashtu, të gjithë të interesuarit për aplikim në kuadër të PZhR-2024, nëse hasin në ndonjë paqartësi gjatë periudhës së aplikimit, mund të parashtrojnë pyetje për sqarim në emailin zyrtar, infoaplikimet.azhb@rks-gov.net.

Kontakti dhe vendi informues lidhur me aplikimin

MBPZHR / AZHB

Adresa: Rruga „Ukshin Hoti“ kati i IX, 10 000 Prishtinë

Nga e hëna deri të premten nga ora 10:00 – 12:00 dhe nga ora 13:00 – 15:00

Tel: 038/200 38 871